



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

**RAPORT MBI
KONSULTIMIN PUBLIK TË PALËVE TË INTERESIT
NR. 3/2013**

5 qershor 2013

I. TË PËRGJITHSHME

Ky raport është hartuar në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesit, lidhur me projekt-rregulloren e AAC-së, në vijim:

- **Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 02/2010 për shënjimin e pengesave**

Kjo projekt-rregullore ka qenë në procedurë të konsultimit publik nga data 14- 27 maj 2013. Marrja e komenteve dhe vërejtjeve të palëve të interesit për këtë projekt-rregullore është bërë duke aplikuar procedurën e paraparë në nenin 5.3 të Udhëzimit Administrativ Nr.1/2012 (konsultimi me shkrim) duke marrë parasysh se nuk janë plotësuar kushtet për organizimin e takimit me palët e interesit, siç parashihet me nenin 5.4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012.

Thirrja për konsultim publik të palëve të interesit i është dërguar të gjithë hisedarëve në industrinë e aviacionit civil, duke përfshirë ANP "Adem Jashari" dhe aviokompanitë që operojnë në të, institucionet aeronautike të Republikës së Kosovës, dhe më gjerë.

II. KOMENTET E PRANUARA DHE PËRGJIGJET E AAC-së

- **Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores nr. 02/2010 për shënjimin e pengesave**

Është hartuar me qëllim të harmonizimit të plotë me kërkesat e standardeve të ICAO-së dhe legjislacionin në fuqi të rregullores nr. 02/2010 për shënjimin e pengesave.

Komente:
Nuk ka

III. PËRFUNDIM

Gjatë fazës së konsultimit publik të palëve të interesit lidhur me projekt-rregulloret nën pikën I të këtij raporti, nuk janë pranuar vërejtje/komente.

Raporti është hartuar nga:

Departamenti aerodromeve
Zyra për çështje juridike dhe rregullatore